



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË



NOTER ELMIRA XH. KODRA
ADRESA NR.10, RR. E DURRESIT,
NR.192, NR.4, NR.6
TEL: 4223812129

PËRPILIM DHE VËRTETIM TË SH.P.K.-VE (AKT THEMELIMI DHE STATUT)


Nr. repertori: 61

Nr. koleksioni: 25

Tirane më 28/01/2023

Ligjet referuese:

- 1.Liqji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Liqji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Liqji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar





A2023052470003289576

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI
TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“Magna Artists Agency” Sh.p.k.**

Sot, më datë 28.01.2023, para meje Notere ELMIRA XH. KODRA, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.10, RR. E DURRESIT, NR.192, NR.4, NR.6, u paraqit personalisht:

THEMELUES:

Maria Pia Sasso, atësia Girolamo Nino, amësia Giovanna, shtetase Italiane, lindur në Bischelie (BA), Itali dhe banuese në Bari, me adresë: Capito Francesco Gentile, Nr.8, Bischelie (BT), lindur më 06/06/1977, gjendja civile “Nubile”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Pasaporte Biometrike nr. YB1328458 dhe nr. personal ITA7706068F.

THEMELUES:

Francesco Leaci, atësia Raffaele, amësia Cosima, shtetas Italian, lindur në Nardo (LE) dhe banues në Lecce, Itali, me adresë via "Galipoli" 67, Nardo, (LE), Itali, lindur më 06/01/1981, gjendja civile "Celibe", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Pasaporte Biometrike nr. YB9619654 dhe nr. personal ITA8101062M.

THEMELUES:

Shoqëria "Morph" sh.p.k., regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS M02124027C, datë 24.09.2020; me seli në Tirane, me adresë Rruga "Kavajes", Qendra Sun Tower, Mbi Raiffeisen Bank, Kati 8, Ap. 45, përfaqësuar nga Administratori Klodian Makashi, atësia Andrea, amësia Leonora, shtetas shqiptar, lindur në Berat dhe banues në Tiranë, me adresë Lagja 13, Rr Ullinjve; Nd. 28; H. 22; Ap. 2; Farkë; Selitë; 1045; Tiranë, lindur më 06/12/1980, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 032363748 dhe nr. personal I01206082D.

I quali, nella qualita dei “Soci costitutivi”, mi hanno chiesto di compilare questo atto di costituzione, e statuto, nepermjet te ciles ata kane deklaruar me deshire te lire dhe te plete, dhe me iniciativen e tyre private, bazuar ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe ne Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin Per Qendren Kombetare te Bisnesit”, ne Kodin Doganor, Fiskal e Taksave, qe duan te themelojne kete shoqeri tregtare, me perqejjesi te kufizuar, me emertimin “Magna Artists Agency” sh.p.k. Te cilet, me cilesine e ortakeve themelues, me kene kerkuar te hartojne kete akt themelimi dhe statut te shoqerise me perqejjesi të kufizuar, me emertimin “Magna Artists Agency” sh.p.k.

KREU I

Emertimi, forma juridike, selia, kohezgjatja, objekti

Neni 1

Emertimi

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është “Magna Artists Agency” sh.p.k..

Neni 2

Forma juridike

Shoqeria “Magna Artists Agency” sh.p.k., eshte person juridik i te drejtës shqiptare, shoqeri me perqejjesi te kufizuar (me poshtë e quajtur “Shoqeria”),, e themeluar nga personat e mesiperm, te cilet nuk pergjigjen per detyrimet e shoqerise tregtare dhe mbulojne personalisht humbjet e shoqerise deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te nenshkuara.

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Regjistrimit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.



A2023052470003289576

Secili ortak gezon kuoten e tij ne shoqeri, ne perpjestim me kontributin qe ka dhene ne kapital.

Neni 3

Selia

Shoqeria e ka seline ne Tirane, me adresen: Rruga "Ismail Qemali", Hyrja 1, Ap.28

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te asamblese se ortakeve.

Neni 4

Objekti

Shoqeria ka per objekt te veprimtarise se saj ushtrimin e aktiviteteve te mëposhtme:

- Manaxhim artistesh, këngetaresh, aktoresh, etj.
- Organizim eventesh, aktivitete, koncerete, festival, etj.
- Negocim artistesh, rezervim datash, artistesh shqiptare dhe te huaj.

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 lekë, i perbere nga 3 kuota

Kapitali i mesiperm eshte nënshkruar dhe shlyer teresisht nga ortakët e shoqerise perkatesisht :

1. Maria Pia Sasso, mbajtese i 1 kuote, me vlore te per gjitheshme 25.000 leke, qe bejne 25% te kapitalit themelor te shoqerise.
2. Francesco Leaci, mbajtes i 1 kuote, me vlore te per gjitheshme 25.000 leke, qe bejne 25% te kapitalit themelor te shoqerise.
3. Shoqeria "Monopoli" sh.p.k., mbajtes i 1 kuote, me vlore te per gjitheshme 50.000 leke, qe bejne 50% te kapitalit themelor te shoqerise

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund te përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.

Neni 7

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit te nje eksperti te autorizuar per keto kontribute.

Në asnje rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kerkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Projekti i zvogëlimit të kapitalit u komunikohet ekspertëve kontabël të autorizuar, në rast se ka të tillë, të paktën 45 ditë përrpara datës së mbledhjes së asamblesë të thirrur për të marrë vendim rreth këtij projekti.

Neni 8

Transferimi i kapitalit



A2023052470003289576

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- d) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Ky statut kushtëzon kalimin e kuotave te treteve jashte shoqerise, me miratimin e shoqërisë dhe të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë, sipas modalitetave dhe shumices se cilesuar qe kerkon ndryshimi i statutit.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 9

Organ i vendimmarres

Asambleja e ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modalitetave te percaktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqerinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshire përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 10

Mënyra e thirrjes se mbledhjes se asamblese se përgjithshme



A2023052470003289576

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 11

Kuorumi

a) Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

b) Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorimit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 12

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpérndarjen e fitimeve, miratimin e bilancit, kontrollin e llogarive, miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë, riorganizimin, bashkimin ose ndarjen e shoqerise, shnderimin ne një forme tjeter, transferimin e kuotave, emerimin e eksperteve dhe likuidatoreve dhe prishjen e shoqërisë, zhvillon mbledhje, te cilat jane te vlefshme, kur ne te jane te pranishem ortaket me te drejte vote qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te kuotave te kapitalit te shoqerise te cilet votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji, dhe merren vendime te vlefshme me votimin pro te $\frac{3}{4}$ te ortakeve pjesemarres.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, kur ne te marrin pjesë ortakët me të drejtë vote te cilet zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave për çështje te tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emerimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) përcaktimin e shpérblimeve

d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;

- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;

Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane Qendres Kombetare te Regjistrimit per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 13

Administrimi

Shoqeria do te administrohet nga një administrator. Administratore te shoqerise është Maria Pia Sasso. Administratori do te ushtroje detyrat e tij sipas statutit dhe ligjit per një periudhe 5 vjeçare.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Administratori mund të heqë dorë në çdo kohë nga detyra e tij, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtar asamblesë së përgjithshme. Administratori, që jep dorëheqjen, duke pasur parasysh rrethanat



A2023052470003289576

e veprimtarisë së shoqërisë, është gjithashtu i detyruar të thërrasë asamblenë e përgjithshme për emërimin e administratorit të ri, përpala datës në të cilën dorëheqja të hyjë në fuqi.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk vendos emërimin e administratorit të ri në datën e përcaktuar në thirrjen e kryer nga administratori i dorëhequr, atëherë administratori i njofton me shkrim dorëheqjen Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, së bashku me kopjen e thirrjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme dhe Qendra Kombëtare e Regjistrimit regjistron largimin e administratorit, sipas procedurave të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar. Dorëheqja e administratorit nuk cenon paditë e shoqërisë për shkelje të detyrimit të besnikërisë që administratori ka ndaj saj, sipas këtij ligji".

Përveç kësaj, administratori shkarkohet nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve.

Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Administrator i shoqerise mund te emerohet edhe një person jashtë ortakerise.

Neni 14 Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

te kryejë të gjitha veprimet e administrimit te zakonshem të veprimtarisë tregtare së shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga ortaku i vetem,

b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;

c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

c) përgatisi dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpala asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rr Ethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojë përpala ortakut në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori përfaqëson shoqërinë përpala të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteteve shtetërore shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallevet, bankat e te gjitha niveleve, zyrat e tatim taksave, doganave, zyrave te qeverisjes vendore etj.

Administratori nuk ka te drejte te nenshkrue kontrata huaje, hipoteke, pa marre me pare miratimin me shkrim te asamblese se ortakeve.

Administratori eshte i detyruar të thërrasi mbledhjen e asamblese se ortakeve edhe ne rastet kur :

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston reziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe
- kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të tij, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Neni 15 Pergjegjesite

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose



A2023052470003289576

solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimitarës së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

d) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

c) u shpérndan aktivet shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimitarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpérblimin financiar, nëse është e nevojshme.

Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkessë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Neni 16 Viti Financiar

Viti financiar i shoqerise fillon me 1 janar dhe perfundon me 31 dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

Neni 17 Bilanci i shoqerise dhe dividentet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, mbledhja e ortakeve, miraton bilancin e paraqitur nga administratori/et.

Mbledhja e ortakeve vendos rrëth shperndarjes se dividentit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 18 Eksperet

gjef

R

D



A2023052470003289576

Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithe dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithvejetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer një gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergaatit reportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit finanziar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

Neni 19

Të ardhurat neto (Dividenti) qe mbeten pas vecimit të fondevit ligjore të mesiperme dhe të atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të treteve, i mbeten dhe i kalojne ne pronesi te ortakeve.

Neni 20 Prishja e shoqerise

1. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:
 - a) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
 - b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
 - c) në rast se objekti bëhet i parealizueshëm për shkak të mosfunkcionimit të vazduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
 - ç) në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 i këtij ligj;
 - d) në raste të tjera, të parashikuara në statut;
 - dh) në raste të tjera, të parashikuara me ligj;
 - e) për çdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e ortakëve.
2. Prishja e shoqërisë, si pasojë e një apo më shumë prej shkaqeve të përcaktuara në shkronjat "a", "c", "d", "dh" dhe "e", të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga asambleja e ortakëve me shumicën e parashikuar sipas pikës 1, të nenit 87, të ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".
3. Në rast mosveprimi të asamblesë së ortakëve për të vendosur prishjen, për shkaqet e përcaktuara në shkronjat "a", "c", "d", dhe "dh", të pikës 1, të këtij neni, çdo person i interesuar mund, në çdo kohë, t'i drejtohet gjykatës për të konstatuar prishjen e shoqërisë.
4. Pavarësisht nga parashikimet e sipërpermendura, ekzistenza e një a më shumë shkaqeve, të parashikuara nga shkronjat "a", "c", "d", "dh" dhe "e", të pikës 1, të këtij neni, nuk do të ketë si pasojë prishjen e shoqërisë dhe hapjen e procedurave të likuidimit, nëse përpara vendimit gjyqësor të formës së prerë, të përmendur në pikën 3, të këtij neni, shkaku i prishjes është korrigjuar, nëse është e mundshme të korrigohet, dhe ky korrigjim është publikuar nga shoqëria në regjistrin tregtar, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar.
5. Prishja e shoqërisë, si pasojë e shkaqeve të parashikuara në shkronjën "b", të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga gjykata kompetente për procedurat e falimentimit, kur, në përfundim të këtyre procedurave, të gjitha pasuritë e shoqërisë janë likuiduar për shlyerjen në mënyrë kolektive të detyrimeve ndaj kreditorëve apo kur gjykata kompetente për procedurat e falimentimit vendos rrëzimin e kërkësës për hapjen e procedurës së falimentimit për shkak të pamjaftueshmërisë së pasurisë së shoqërisë për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit.
6. Prishja e shoqërisë si pasojë e shkaqeve të parashikuara në shkronjën "ç", të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga gjykata kompetente, sipas parashikimeve të nenit 3/1 të 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

Neni 21 Likuidimi



A2023052470003289576

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emëritit të tij.

Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përvçese kur akti i emëritit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.

Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit.

Likuiduesi u nënshtrohet mbikëqyrjes së ortakut dhe administratorit/eve.

Neni 22

Të drejtat e detyrimet e likuiduesit

1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të kodit civil.

2. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.

3. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjafueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet në shoqerinë kolektive dhe komandite miratohen nga ortakët e tjerë, ndërsa në shoqëritë aksionare apo nga ato me përgjegjësi të kufizuar miratohen nga asambleja e përgjithshme.

Neni 23

Përfundimi i likuidimit

Pas shpérndarjes së aktiveve të mbetur, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Neni 24

Bashkimi

Dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:

1. Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njërsës ose më shumë prej shoqërive, që quhen shoqëritë e përthithura, të një shoqëri tjeter ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të kësaj shoqërie. Ky proces quhet bashkim me përthithje.

2. Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalohen të gjitha aktivet e pasivet e shoqërise ekzistuese, që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re. Ky proces quhet bashkim me krijim i një shoqërie të re.

Neni 25

Ndarja

1. Një shoqëri mund të ndahet me vendim të asamblese se ortakeve, duke transferuar të gjitha aktivet e pasivet e veta në favor të dy ose me shumë shoqërise ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet, vlerësohet e prishur.

2. Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatesisht dispozitat e neneve të ligjit nr.9901, date 14.04.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar me ligjin 129/2104.

3. Shoqëritë, që fitojnë pasuritë e shoqërisë që ndahet, quhen shoqëri pritëse dhe përgjigjen në mënyrë solidare për detyrimet e kësaj të fundit.

4. Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit ka si pasojë:

a) kalimin te shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që ndahet, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja për marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, si dhe për palët e treta;



A2023052470003289576

b) bërjen e aksionarëve/ortakëve të shoqërisë që ndahet aksionarë apo ortakë të një ose më shumë shoqërive pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes, përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes;

c) vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, sipas seksionit V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" pa kryerjen e likuidimit.

Neni 26
Shnderrimi

Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit te saj në shoqëri aksionare Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimet, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.

Neni 27
Baza ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plete me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 28
Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 29
Dispozita perfundimtare

Ky Akt Themelimi dhe Statut u redaktua ne 4 ekzemclare me permabjtje dhe vlera te nejta juridike, ne gjuhen shqipe, u lexua dhe ne gjuhen italiane nga perkthyesi Vjola Goda, e miratuar nga Ministria e Drejtësise, miratohet ne parim dhe nen per nen nga ortaket themelues te shoqerise tregtare "Magna Artists Agency" sh.p.k., dhe nenshkruhet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen orgjinale.

Unë Noterja verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përbajtjen e aktit notarial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 e vijues të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre. Në zbatim të ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënavë personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

THEMELUES
Maria Pia Sasso

THEMELUES
Francesco Leaci

Maria Pia Sasso
THEMELUES
Shoqeria "Morph" sh.p.k.
Perfaqesuar nga administratori
Klodian Makashi

Perkthyes
Vjola Goda

MORPH
Sh.p.k.
NUIS: M02124027C TIRANA - ALBANIA

NOTE RE
ELMIRA XI. KODRA

VJOLA GODA
Traduttore Licurato
Perkthyes Licencuar



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	M02124027C
2. Data e Regjistrimit	24/09/2020
3. Emri i Subjektit	MORPH
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	21/09/2020
6. Kohëzgjatja	Nga: 21/09/2020
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Rruga e Kavajes, Qendra Sun Tower, mbi Raiffeisen Bank, Kati 8, Ap. 45
8. Kapitali	100,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	3,00
9. Objekti i aktivitetit	Kryerja e investimeve, blerjeve, shitjeve, ne pjese ose ne total te kapitalit themeltar pjesemarres ne shoqeri tregtare te formave dhe te aktiviteteve te ndryshme, shqiptare ose te huaja. Pjesemarrje ne kapital te shoqerive tregtare te formave dhe te aktiviteteve te ndryshme, shqiptare ose te huaja. Marrje pjese, jo ndaj publikut, ne shoqeri tregtare te tjera te cdo forme dhe me cdo objekt te mundshem, apo ndermarrje te çdo lloji dhe me çdo objekt te mundshem, shqiptare ose te huaja. Planifikim, organizim dhe kontroll strategjik dhe operativ te veprimtarive/aktiviteteve dhe vendimmarrjeve te shoqerive tregtare ne te cilat merr pjese. Ofrimin e sherbimeve juridike, financiare, tregtare, administrative, kontabel dhe teknike ne favor te shoqerive tregtare ne te cilat merr pjese. Per qellime te permbushjes se objektit te veprimtarise se saj, shoqeria mund te jape financime ne favor te shoqerive tregtare ku merr pjese, si dhe te lesjohe garanci ne favor te institucioneve financiare apo ndermjetesuesve financiare. Per realizimin e objektit te veprimtarise se saj, shoqeria mund te kryeje, gjithashtu te gjitha veprimet mbi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

	pasuri te luajtshme dhe te paluajtshme, industriale, financiare(pasi te jetë pajisur paraprakisht me lejet e nevojshme te leshuara nga organet kompetente) dhe tregtare, ne Shqiperi si dhe jashtë saj, ne masen qe vleresohet e dobishme dhe/ose e pershtatshme nga organi administrativ dhe mundet gjithashtu te kete pjesmarrje ne kapitalin themeltar te shoqerive ose ndermarrjeve dhe ose entiteteve te tjera ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi, si dhe cdo aktivitet tjeter te lejuar nga ligjet ne fuqi. Ne perputhje me legjislacionin shqiptar, Shoqeria mund te kryeje çdo aktivitet qe lidhet direkt ose indirekt, rrjedh apo ka te beje me objektivat e renditura sa me lart. Per te arritur qellimet e mesiperme, Shoqeria mund te nndermarre aktivitet tregtar, finansiar, qe mund te konsiderohet i dobishem apo i nevojshem ne menyre qe te arrihet dhe permbushet objekti i Shoqerise.Te gjitha veprimtarite e pershkruara me siper mund te zhvillohen si ne Shqiperi ashtu edhe jashtë saj	
10. Administratori/ët 10.1 Afati i emërimit	Klodian Makashi Nga: 22/09/2020 Deri: 22/09/2025	
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore 11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët 12.1 Vlera e kapitalit 12.2 Numri i pjesëve 12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) <i>*Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)</i>	KlodianMakashi Para: 56,00 Natyre: 1,00 56,00	
12.4 Komente (nëse ka)		
13. Ortakët 13.1 Vlera e kapitalit 13.2 Numri i pjesëve 13.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) <i>*Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)</i>	UardaKoçi Para: 24,00 Natyre: 1,00 24,00	
13.4 Komente (nëse ka)		



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

14. Ortakët	Renald Rista	
14.1 Vlera e kapitalit	Para: 20,00	Natyre:
14.2 Numri i pjesëve	1,00	
14.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	20,00	
*Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)		
14.4 Komente (nëse ka)		
15. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit		
16. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: MORPH E-Mail: klodianmakashi@gmail.com Telefon: 0672079391	
17. Statusi:	Aktiv	

Datë: 28/01/2023

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nepunësit të sportelit)



Vulosur elektronikisht nga
Qendra Kombëtare e Biznesit
Date: 2023/01/28 13:32:56 +01:00
M02124027C2023012813324767
2006

Shoqeria "MORPH" sh.p.k.,
NIPT M02124027C

VENDIM I ASAMBLESE SE ORTAKEVE
date 26/01/2023

Sot më datë 26/01/2023, asambleja e ortakeve te shoqerise "MORPH" sh.p.k., me qender në Tirane, rruga "Kavajes", Qendra Sun Tower, mbi Raiffeisen Bank, kt.8, ap.45, e regjistruar në Regjistrin Tregtar (QKB) me numër unik identifikimi (NUIS) M02124027C, u zhvillua mbledhja e asamblese se ortakeve në ambientet e shoqërisë, me kërkësë të administratorit Klodian Makashi.

Ortaket prezent në mbledhje:

1. Klodian Makashi, i biri i Andreas, lindur ne Berat, me 06/12/1980, banues ne Tirane, mbajtes i leternjoftimit nr 032363748, numer personal I01206082D, madhor, me zotesi te plete juridike per te vepruar, ortak, zoterues i 1 kuote, me vlerë 56 leke qe perfaqeson 56% të kapitalit të shoqërisë "MORPH" sh.p.k.,
2. Uarda Koçi, e bija e Josifit, lindur ne Patos, Fier, me 02/09/1987, banuese ne Tirane, mbajtese e leternjoftimit nr 031489913, numer personal I75902012T, madhore, me zotesi te plete juridike per te vepruar, ortake, zoteruese e 1 kuote, me vlerë 24 leke qe perfaqeson 24% të kapitalit të shoqërisë "MORPH" sh.p.k.,
3. Renald Rista, i biri i Ligorit, lindur ne Fier, me 24/11/1978, banues ne Tirane, mbajtes i pasaportes nr BE2991895, numer personal H81124087H, madhor, me zotesi te plete juridike per te vepruar, ortak, zoterues i 1 kuote, 20 leke qe perfaqeson 20% të kapitalit të shoqërisë "MORPH" sh.p.k.,

Mbledhja vleresohej e vlefshme sipas ligjit dhe statutit, pasi ne te marrin pjese 100% e zoteruesve te kapitalit te shoqerise, çfare kupton se quorumi per zhvillimin e kesaj mbledhje eshte i plotesuar.

Ortaket e shoqërisë caktuan administratorin Klodian Makashi, për drejtimin e kësaj mbledhje i cili filloj drejtimin e mbledhjes sipas rendit të ditës te njoftuar:

RENDI I DITËS

- Krijimin e nje shoqerie me perjegjesi te kufizuar e emertuar "Magna Artists Agency" sh.p.k., me zyre ne Shqiperi, me seli ne Tirane adresë: Rruga e Kavajes, Qendra Sun Tower, katë 8, ap.43. me kapital 100 leke, numri i per gjithshem i kuotave 3.
- Ortaket e shoqerise do te jene:
 - 1- Shoqeria "MORPH" sh.p.k., e cila do te jetë zoteruese e 1 kuote me vlerë 50 leke, qe perfaqesojne 50% te kapitalit,
 - 2- Maria Pia Sasso zoteruese e 1 kuote me vlerë 25 leke, qe perfaqeson 25% te kapitalit dhe
 - 3- Francesco Leaci zoterues i 1 kuote me vlerë 25 leke qe perfaqeson 25% te kapitalit te shoqerise.
- Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

Në përfundim, pas shqyrtimit të rendit të ditës, mbështetur ne ligjin nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qëndrën Kombetare te Regjistrimit" dhe ligjin Nr.9901, date 14.04.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", te ndryshuar, asambleja e ortakeve,

VENDOSI:

- Krijimin e nje shoqerie me perjegjesi te kufizuar e emertuar "**Magna Artists Agency**" sh.p.k., me zyre ne Shqiperi, me seli ne Tirane adresë: Rruga e Kavajes, Qendra Sun Tower, kati 8, ap.43. me kapital 100 leke, numri i pergjithshem i kuotave 3.
- Ortaket e shoqerise do te jene:
 - 1- Shoqeria "**MORPH**" sh.p.k., e cila do te jetë zoteruese e 1 kuote me vlerë 50 leke, që perfaqesojne 50% te kapitalit,
 - 2- Maria Pia Sasso ziterusese e 1 kuote me vlerë 25 leke, që perfaqeson 25% re kapitalit dhe
 - 3- Francesco Leaci zoterues i 1 kuote me vlerë 25 leke që perfaqeson 25% te kapitalit te shoqerise.
 - Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per një periudhe te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

Autorizohet zoti Klodian Makashi, per kryerjen e të gjitha veprimeve ligjore dhe nenshkrimin e te gjitha akteve te nevojeshme per krijimin e shoqerise "**Magna Artists Agency**" sh.p.k.,

ASAMBLEJA E ORTAKOVE TE SHOQËRISË
"**MORPH**" sh.p.k.,

Klodian Makashi

Klodian Makashi


Uarda Koçi

Uarda Koçi


Renald Rista

Renald Rista